

PROCESVERBAL - Tipi i kontrates - Sherbime

**PER ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PER KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal eshte per efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURES: KOLAUDIMI I APARATEVE TË SISTEMIT TË NGROHJES

KODI PERKATES NE FJALORIN E PERBASHKET TE PROKURIMIT (CPV):

Kodi CPV: 71630000-3 - Inspektime teknike dhe analiza.

VLERA E FONDIT LIMIT: 3 195 000 (tre milion e njëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë) Lekë pa Tvsh.

Ne baze te nenit 21, pika 2, te Ligjit nr.162/2020 "Per prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Drejtoria e Pergjithshme e Objekteve Publike**, ka hartuar procesverbalin per argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterave per kualifikim per proceduren e sipercituar, me permbajtjen si me poshte:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet te paraqese:

- a. Sigurimin e ofertes, sipas shtojces 3;
- b. Formulari permbledhes i vetedeklarimit, sipas shtojces 9, te DT.

Argumentimi: Kerkesat e mesiperme bazohen ne nenet 76, 82 dhe 83 te LPP, nenit 26, te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet te paraqese:

2.1 Kapaciteti profesional i operatoreve ekonomike:

2.1.1 Operatori ekonomik ofertues duhet te jete i pajisur me certifikatë Akreditimi për fushat:

- 1. Inspektim per pajisjet nën presion (enëve kriogjenike, tubacioneve, rezervuarë nën presion);
- 2. Inspektim për provat pa shkatërrim NDT-Prova me ultratinguj;
- 3. Inspektim per provat pa shkatërrim NDT-Termografi;
- 4. Matje e rezistencës së togezimit.
- 5. Operatori ekonomik ofertues duhet të jete i pajisur me Akt Miratimi si "Organ i miratuar i vlerësimit të konformitetit", nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për fushat e akredituara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është percaktuar bazuar në nenin 77 pika 2, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", , nenit 41, pika 4 , gërma a) e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar, si dhe në zbatim të Ligjit nr.32/2016 datë 24.03.2016 "Për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve nën presion", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1062 datë 23.12.2015 "Për miratimin e rregullit per pajisjet dhe bashkesitë nën presion dhe percaktimin e lëstës së standarteve të harmonizuara" dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1065 datë 23.12.2015 "Për miratimin e rregullit teknik për enët e thjeshta nën presion", Urdhërin e Ministrisë nr.53 datë 05.10.2017 "Për miratimin e rregullores "Për procedurat e miratimit dhe mbikqyrjes së organeve europiane të notifikuara dhe organeve të miratuara të vlerësimit të konformitetit".

Percaktimi i kategorisë së fushave të akreditimit bazohet në kriteret të percaktuara ligjore e teknike.

Të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore në fuqi dhe janë në përputhje me

natyrën dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kerkohet që operatorët ekonomikë të japin garanci që i kanë aftësite tekniko-profesionale ne nivele të kategorive të kerkuara per realizimin e objektit që prokurohet. Me anë të këtij kriteri kerkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë akreditimin dhe çertifikimin e nevojshëm profesional që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente. Çertifikimet e kërkuara janë të lidhura ngushtësisht me zerat e shërbimeve të pasqyruara në preventiv. Operatorët ekonomike, per te marre pjesë ne procedurat e prokurimit, duhet te kualifikohen, pasi të kenë permbushur te gjitha kriteret, që autoriteti i vlereson te nevojshme, per sa kohe ato janë në perpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

2.1.2 Operatori ekonomik ofertues duhet te jete pajisur me certifikaten ISO 9001ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit te cilesise, e cila te perfshije objektin e prokurimit, si dhe te jete e vlefshme.

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme bazohet ne nenin 77, pika 1/a), nenin 79 te LPP, nenit 44 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", eshte kerkuar kjo certifikate me qellim qe operatoret ekonomike qe do te zbatojne kontraten te jene certifikuar ne sistemin e menaxhimit te cilesise. certifikata duhet te jete e leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise. Nisur nga rendesia, volumi i kontrates, rendesia e AK (Autoritetit kontraktor) te perfshire ne kete procedure eshte e rendesishme me qellim realizimin me sukses te kesaj procedure qe operatori pjesemarres te provojne se ka nje sistem te menaxhimit te cilesise, pra te demonstrojne aftesine e tij per te ofruar vazhdimisht sherbime qe plotesojne kerkesat e konsumatoreve pra te AK-se dhe kerkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qellim te rrise kenaqesine e konsumatorit nepermjet zbatimit efektiv te sistemit, duke perfshire proceset per permiresimin e vazhdueshem te sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj klientit pra Ak-se.

2.1.3 Operatori ekonomik ofertues duhet te jete pajisur me certifikaten ISO 45001 ose ekuivalente, lidhur me sistemin te shendetit dhe sigurise ne pune, e cila te perfshije objektin e prokurimit, si dhe te jete e vlefshme.

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme bazohet ne nenin 77, pika 1/a), nenin 79 te LPP, nenit 44 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", është kërkuar kjo certifikate me qellim që operatoret ekonomike që do të zbatojnë kontratën të jene certifikuar në sistemin e shendetit dhe sigurisë në punë. certifikata duhet te jete e leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise. Kjo certifikate eshte kerkuar pasi ofron nje kuader per menaxhimin efikas te shendetit dhe sigurise ne pune perfshire gjithe aspektet e menaxhimit te riskut dhe te perputhshmerise ligjore nga operatore ekonomike, te cilet do te ekzekutojne keto kontrata sherbimi. Nje OE i certifikuar sipas ketij standardi eshte ne gjendje te:

- Krijoje kushtet mete mira te punes ne gjithe organizaten e tij;
- Identifikoje kercenimet dhe vendos kontrollin per menaxhimin e tyre;
- Redukton aksidentet dhe semundjet ne vendin e punes duke minimizuar kostot dhe kohen Joproductive;
- Perfshin dhe motivon stafin me kushte mete mira dhe mete sigurta pune;
- Dëshmon perputhshmeri ndaj klienteve dhe furnitoreve;

Te gjitha keto jane garanci se OE i shpallur fitues i cili eshte i certifikuar sipas ketij standardi ka kapacitetet e duhura per realizuar me sukses kontratat me AK-te.

2.1.4 Operatori ekonomik ofertues duhet te jete pajisur me certifikaten ISO 14001 ose ekuivalente, lidhur me sistemin menaxhimit te mjedisit, e cila te perfshije objektin e prokurimit, si dhe te jete e vlefshme.

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme bazohet ne nenin 77, pika 1/a), nenin 79 te LPP, nenit 44 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", është kërkuar kjo certifikate me qellim që operatoret ekonomike që do të zbatojnë kontratën të jene certifikuar në sistemin e menaxhimit te mjedisit. Certifikata duhet te jete e leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise. Kjo certifikate eshte kerkuar pasi ofron nje kuader praktik për shoqëritë që menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi nga operatore ekonomike, te cilet do te ekzekutojne keto kontrata

sherbimi.

2.1.5 Organi i vleresimit te konformitetit te certifikatave ISO te kerkuara per operatorin ekonomik ofertues te jete i akredituar nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit ne Republiken e Shqiperise ose nga nje organizem nderkombetar akreditues i njohur nga Republika e Shqiperise.

Argumentimi: Kerkesa e mesiperme bazohet ne nenin 77, pika 1/a), nenin 79 pika 2 c) te LPP, nenit 44 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik". Ky kriter eshte vendosur ne permbushje te detyrimeve ligjore qe percaktojne Ligji nr.116/2014, date 11.09.2014 "Per akreditimin e organeve te vleresimit te Konformitetit", Ligji nr.10489 date 15.12.2011 "Per tregtimin dhe mbikeqyrjen e tregut te produkteve joushqimore", VKM nr. 667, date 29.7.2015 "Per organizimin dhe funksionimin e Drejtorise se Pergjithshme te Akreditimit".

certifikatat e leshuara nga ente certifikuese te pa akredituara nuk garantojne efikasitetin dhe sigurine per kerkesat e cilesise te cilat autoriteti kontraktor i kerkon per realizimin e kontrates.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2022, 2023, 2024) të çertifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kerkesa e mesiperme eshte percaktuar bazuar ne nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik". Percaktimi i viteve te kerkuara per paraqitjen e bilanceve eshte bere duke iu referuar legjislacionit te tushes, ndersa kushti qe bilancet duhet te shoqerohen edhe me akt-ekspertizen e ekspertit kontabel te autorizuar eshte vendosur ne zbatim te nenit 41, te ligjit nr.10091, date 05.03.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e protesionit te audituesit ligjor dhe te kontabilistit te miratuar" i ndryshuar. Kerkesa per paraqitjen e bilanceve eshte vendosur duke pasur ne konsiderate objektin e kontrates, natyren dhe volumen e saj, qe t'i sherbejne autoritetit kontraktor per njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve te operateve ekonomike, te cilet, nepermjet dokumentacionit te paraqitur duhet te vertetojne se zoterojne kapacitetet e nevojshme, gjith9ka ne funksion te realizimit me sukses te kontrates. Percaktimi i viteve te kerkuara per paraqitjen e bilanceve eshte bere duke iu referuar legjislacionit te tushes, konkretisht, ne Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise" (i ndryshuar), dhe aktet nenligjore ne zbatim te tij.

2.2.2 Xhiroja vjetore e operatorit ekonomik ofertues gjate 3 (tre) viteve te fundit (2022, 2023, 2024) te jete jo me e vogel se 40% e vleres se tondit limit dhe kjo te jete e vertetuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shkrese ose me dokument te nxjerre online me vule elektronike. Ky kriter konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kerkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kerkesa e mesiperme eshte percaktuar bazuar ne vleren e tondit limit te kesaj procedure, si dhe bazuar ne nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" Udhezimin Nr. 7, date 10.1.2017 "Per disa shtesa ne Udhezimin Nr. 24, date 2.9.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise" (te ndryshuar). Ne percaktimin e ketij kriteri eshte mbajtur ne vemendje neni 29 i Ligjit Nr. 8438, date 28.12.1998 "Per tatimin mbi te ardhurat tatimore" (te ndryshuar), ku citohet:

.....çdo tatimpagues pergatit deklaraten vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e percaktuar në Udhezimin e Ministrit te Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaraten vjetore ne organet tatimore brenda dates 31 mars te vitit pasardhes, duke paraqitur ne tenjejten kohe bilancin kontabel, sebashku me anekset e tij, si dhe çdo te dhene tjeter tepercaktuar ne udhezimin e Ministrit te Financave ne zbatim te ketij

ligji".... Percaktimi i vleres se kerkuar eshte ne perpjestim te drejte me fondin limit te procedures. Kerketat e mesiperme i sherbejne autoritetit kontraktor per njohjen e gjendjes financiare te operatoreve ekonomike dhe te mundesise se tyre per permbushjen me sukses te kontrates.

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet te mos kete detyrime per taksat vendore per Vitin 2025 (ku te perfshihet kesti per periudhen perkatese te maturuar sipas Ligjit Nr.9632 date 30.10.2006 "Per sistemin e taksave vendore", i ndryshuar), dukeparaqitur nje vertetim nga organet e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin. Ne rast bashkimi operatoresh ekonomike, vertetimin nga organet e qeverisjes vendore duhet ta kete secili subjekt me vete.

Shenim: Ky kriter (2.2.3) do te konsiderohet i permbushur nepermjet plotesimit dhe paraqitjes nga operatoret ekonomike te formularit permbledhes te vetedeklarimit, sipas Shtojces 10 te DST. Dokumentacioni provues do te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar ne vend te pare, prane autoritetit kontraktor, perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, ose nese do te jete nevoja per t'u kerkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kerketa e mesiperme eshte percaktuar bazuar ne nenin 77, pika 3, e LPP, ne nenin 43, pika 6, te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 "Perprocedurat tatimore" i ndryshuar, neni 4, pika 2, germa d) dhe ne ligjin nr.9632, date 30.10.2006 "Per Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar. Referuar same siper, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorezimin nga ana e operatoreve ekonomike te deklarates per shlyerjen e detyrimeve vendore per vitin 2022 sipas kesteve prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij eshte ne perputhje me kuadrin ligjor ne fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, date 30.10.2006 per "Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar. Te gjitha subjektet qe ushtrojne veprimtari biznesi kane detyrimin ligjor te regjistrimit prane Qendres Kombetare te Biznesit per te bere te identifikueshem vendodhjen e aktivitetit te tyre dheper t'iunenshtuar pageses se taksave vendore te parashikuara shprehimisht ne kete ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet te ketë kryer shërbime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 20% të fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë;

a) Kontrata të realizuara me autoritete kontraktore, të cilat duhet të jenë të shoqëruara me vërtetimin e realizimit me sukses të saj, lëshuar nga autoriteti kontraktor ku të shprehen qartë datat, shumat dhe shërbimet e realizuara ose vërtetimin për realizimin me sukses të kontratës shoqëruar me faturat tatimore të shitjes, ku të shprehen qartë datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) Për shërbime të realizuara me subjekte private operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kerketa e mesiperme eshte percaktuar bazuar ne nenin 77 te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik" dhe nenit 55, pika 4/b VKM-se nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" ne kushtet kur kjo procedure prokurimi klasifikohet procedure e hapur e thjeshtuar. Me ane te ketij kriteri kerkohet qe operatoret ekonomike te deshmojne qe kane pervojen e nevojshme per te zbatuar kontraten, prandaj eshte kerkuar qe sherbimet e meparshme te ngjashme te jene ne vleren jo me pak se 20% te vleres se fondit limit,

qe eshte brenda vleres kufi te percaktuar ne nenin e sipercituar. Percaktimi i vleres se kerkuar per kontratat e ngjashme argumentohet si me poshte: Ne zbatim te nenit 55, pika 4/b ne kushtet kur kjo procedure prokurimi eshte procedure e thjeshtuar te VKM-se nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik".

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij të punësuar në funksion të realizimit të objektit të prokurimit të pakten 3 (tre) punonjes, për periudhën qershor-gusht 2025 dhe në vazhdim, nga të cilët në stafin teknik gjatë kësaj periudhe të jenë të punësuar për çdo muaj të paktën 1 (një) inxhinier mekanik, 1 (një) inxhinier elektrik, 1 (një) inspektor NDT (industrial non-destructive testing- inspektim për provat pa shkatërrim) të kualifikuar dhe çertifikuar sipas SSH EN ISO 9712 ose ekuivalent për matjen me ultratinguj. Në lidhje me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

Listepagesat e sigurimeve shoqërore të leshuara nga organet kompetente shtetërore, për periudhën qershor-gusht 2025, ku punonjësit me profesionet e kërkuara me sipër të jenë detyrimisht të pasqyruar në to.

- Diplomat perkatese të stafit teknik, kontratat e punës dhe deshmite të kualifikimit profesional të leshuara nga subjekte të licensuara nga organet kompetente shtetërore ose të njohura nga Republika e Shqipërisë.
- Kontratat e punës duhet të kenë një afat vlefshmerie për të gjithë kohezgjatjen e kontratës.
- Vertetim nga organet kompetente shtetërore për numrin e punonjësve të siguruar për periudhën qershor-gusht 2025.

Shënim: Ky kriter (2.3.2) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nënjes së afatëve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kerkohet që operatorët ekonomikë të deshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht: Referuar natyrës së shërbimeve që kerkohen të prokurohen siç janë shërbimet periodike për kontrollin teknik periodik të sistemeve ngrohëse (kaldaja) të objekteve arsimore është e nevojshme pasja e një stafi teknik të vertetur kjo në bazë të arsimimit dhe certifikimit për secilin nga specialistet e konsideruar të nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës. Punonjësit e kualifikuar janë kërkuar duke u bazuar në numrin e objekteve në të cilat do të kryhen shërbimet si dhe natyrën dhe sasinë e shërbimeve që kerkohen. Me qëllim garantimit të realizimit të kontratës, stafi teknik inxhinierik dhe punonjësit e kualifikuar dhe çertifikuar të kërkuar nga autoriteti kontraktor duhet të figurojnë në listepagesat e operatorit ekonomik ofertues.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë minimalisht mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

- 1 (një) Pajisje për matje spesorë të metaleve me ultratinguj.
- 1 (një) Manometër i kalibruar për presion 140 bar.
- 1 (një) Manometër i kalibruar për presion 80 bar.
- 1 (një) Aparat matës i rezistencës së togëzimit.
- 1 (një) Kamera termike -10°C deri 300°C

Për mjetet dhe pajisjet e mësipërme, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dokumentat që vërtetojnë se, këto mjete dhe pajisje i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje/dokumente zhdoganimi/kontrata qiraje/kontrata huapërdorje/ kontrate dhurimi/çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë) dhe fotografi të pajisjeve të mësipërme të cilat disponon aktualisht sipas kërkesave të DST.

Shënim: Ky kriter (2.3.3) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nënjes së afatëve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kerkohet që operatorët ekonomikë të deshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në

dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike per te permbushur kontraten, te nevojshme per ekzekutimin e objektit te prokurimit. Nisur nga fakti se objekt i kesaj kontrate jane sherbime specifike periodike, te cilat duhet te realizohen sipas kushteve teknike te nevojshme, duhet te deshmojne qe kane minimalisht, pajisjet matese dhe testuese te percaktuara me sipër dhe të jenë të kalibruara. Ky kriter eshte vendosur, gjithashtu edhe per arsye se eshte çmuar si e nevojshme zoterimi i ketyre pajisjeve specifike, te konsideruar nga Autoriteti kontraktor si te domosdoshme per realizimin e sherbimit ne perputhje me legjislacionin ne fuqi. Referuar natyres se objektit te prokurimit per realizimin me sukses te sherbimeve eshte nevojshme pajisja e ketyre mjeteve teknike.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike jane hartuar nga grupi i posaçëm, i cili eshte ngritur me Urdher te Titullarit per hartimin e specifikimeve te teknike ne perputhje me nenin 36, te ligjit nr.162/2020 "Per Prokurimin Publik", si dhe nenit 41 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar.

Argumentimin e Fondit Limit:

Për të garantuar sigurinë dhe certifikimin e impianteve ngrohëse (kaldaja) në zbatim të përcaktimeve ligjore të shprehura në Ligjin nr.32/2016 datë 24.03.2016 “Për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve nën presion”, VKM Nr. 730, datë 16.11.2022 “Për miratimin e rregullit teknik “për enët e thjeshta nën presion” dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara” nevojitet të kryhet inspektimi periodik i kaldajave dhe aksesoreve të saj (valvola sigurie, manometra, termometra, termostate etj.) nga një organ i miratuar.

Inspektimet periodike janë thelbësore për identifikimin në kohë të defekteve strukturore dhe funksionale. Këto inspektime përfshijnë metoda testimi jo-shkatërruese si testimi me ultratinguj, radiografia industriale, testimi i grimcave magnetike dhe testet e depërimit të lëngjeve.

Përshkrimi dhe qëllimi i shërbimeve:

Drejtoria e Pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike ka ne administrim te gjitha objektet parashkollore, shkollore, ne adminstrim te Bashkine Tirane, te cilat kryejne funksionet e tyre gjate gjithë periudhes vjetore ku ne periudhen 15 Nentor deri ne 15 Mars, mbulohet sherbimi me ngrohje i ketyre objekteve me ane te impianteve ngrohese (kaldaja). Gjendja teknike e impianteve ngrohese (kaldaja) ne lidhje funksionalitetin e tyre eshte monitoruar nga drejtoria jone me ane te kontratave te sherbimit periodike dhe një strukture te specializuar që ndjek hap pas hapi në vazhdimësi çdo problematike te hasur, duke hartuar edhe nje plan veprimi vjetor per mirembajtjen e tyre në këtë aspekt, pra një planifikim për nderhyrjen teknike te nevojshme ne keto impiante.

Per te garantuar sigurine dhe certifikimin e impianteve ngrohese (kaldaja) ne zbatim te percaktimeve ligjore te shprehura ne Ligjin nr.32/2016 date 24.03.2016 "Per garantimin e sigurise se punes se pajisjeve dhe instalimeve nen presion", nevojitet te kryhet inspektimi periodik i kaldajave dhe aksesoreve te saj (valvola sigurie, manometra, termometra, etj.) nga nje organ i miratuar ne zbatim te rekomandimeve te Inspektoriatit Teknik Shtetror dhe Industrial ne shkresen nr.5760/1prot. date 06.07.2022 dhe shkresen nr.2545 date 10.05.2021.

Detyrat:

Operatori ekonomik kontraktues duhet te realizoje ne kohe, sasi e me cilesi sherbimet e planifikuara, te cilat dote kryhen cdo dite pune, duke u kujdesur per te mos penguar kryerjen e aktivitetit mesimor, Kryerjen e procesit te Inspektimi periodik i vlerësimit te konformitetit te kaldajave dhe aksesoreve te saj do te realizohet ne objektet sipas listes te publikuar ne DST.

Përshkrimi i kerkesave te zbatimit te sherbimeve ne lidhje me to:

Qellimi i Sherbimit te kontrollit teknik periodik te sistemeve ngrohese (kaldaja) te instaluara ne objektet arsimore: Inspektimi periodik i vlerësimit te konformitetit i eneve nen presion dhe aksesoreve te saj (valvola sigurie, manometra, termometra, etj.) ne te gjitha impiantet ngrohese te instaluara.

Objekti i Sherbimit te kontrollit teknik periodik te sistemeve ngrohese (kaldaja) te instaluara ne objektet arsimore: Te kryhet inspektimi periodik i kaldajave dhe aksesoreve te saj (valvola sigurie, manometra, termometra, etj.) nga nje organ i miratuar".

Kontrata zbatohet me plane te programuara ditore duke mbajtur kontakte te perditshem me perfaqesues te AK te ngarkuar per ndjekjen e procedures se zbatimit te kontrates, procedure mete cilin OE njihet zyrtarisht nga AK me fillimin e zbatimit.

Te gjitha mjetet teknike te nevojshme per kryerjen e sherbimit: Pajisje per matje spesori te metaleve me ultratinguj, pajisje per testimin e manometrave, bankoprove per testimin e valvulave te sigurisë, manometer i kalibruar per presion 25 bar, aparat mates i rezistences se tokezimit, aparat mates per gazrat e shkarkimit te kaldajave, termometer per matjen e temperaturës duhet te jene te certifikuara konform standarteve (CE) dhe ne posedim te kontraktuesit.

Lista e kontrolleve te domosdoshme qe duhet te kryhen gjate sherbimit te kontrollit teknik:

- 1) Kontrolli i valvulave te sigurise;
- 2) Kontrolli i manometrave;
- 3) Kontrolli i armaturave;
- 4) Kontrolli i siperfaqeve te jashtme nga korrozioni dhe demtime siperfaqesore;
- 5) Kontrolli dhe niveli i treguesve;
- 6) Kontrolli i linjave te jashtme;
- 7) Matje e emisioneve të djegies;
- 8) Vleresim i sistemit te tokezimit.

Certifikatat dhe licensat qe duhet te zoteroje operatori ekonomik kontraktues:

- 1) Certifikaten ISO 9001 ose ekuivalente per Sistemin e Menaxhimit te Cilesise;
- 2) Certifikaten ISO 45001 ose ekuivalente per Sistemin e Menaxhimit te Shendetit dhe Sigurise ne Pune;
- 3) Certifikaten ISO 14001 ose ekuivalente per Sistemin e Menaxhimit te Mjedisit
- 4) Certificate akreditimi per fushat;
 - a) Inspektim per Kaldajat e Avullit dhe Ujit të nxehtë
 - b) Matje e rezistences se tokezimit.
- 5) Akt miratimi si "Organ i miratuar i vleresimit te konformitetit" nga Ministria e Infrastruktures dhe Energjise per fushat e akredituara.

Stafi teknik i nevojshem qe duhet te zoteroje operatori ekonomik kontraktues:

- 1) 2 (dy) inxhinier mekanik;
- 2) 1 (nje) inxhinier elektrik.

Certifikimi nga kontraktuesi pas kryerjes se sherbimit:

- 1) Ne perfundim te çdo sherbimi kontraktuesi duhet te leshoje Certifikata Konformiteti per secilen nga kaldajat qe dote kryhet kontrolli teknik periodik dhe qe i plotësojnë kushtet e certifikimit.
- 2) Pas leshimit te certifikatave te Konformitetit nga ana e kontraktorit, Inspektori i P.N.P që mbulon zonen, **duhet te plotesoje regjistrat e pajisjeve nen presion sipas rregullores ne fuqi**, ku te percaktohen dhe afatet per kontrollet pasardhëse.
- 3) Kontraktuesi gjate punes per kryerjen e kontrolleve te parashikuara, duhet te zbatoje dhe garantoje te gjitha kushtet e sigurise ne pune, per personelin, dhe mjet mbrojtese te punes konfrom legjislacionit ne fuqi.
- 4) Perfaqesuesi i autoritetit kontraktor dote mbikqyre procesin per te garantuar cilesine teknike te sherbimit, respektimin e kushteve teknike dhe arritjen e objektivave te kontrates.

Vendi dhe afati i kryerjes se shërbimeve:

Vendodhjet e objekteve arsimore ne te cilat dote kryhen shërbimet e kërkuarajane te listuara sipas tabelës se paraqitur ne kete shkresë dhe gjenden brenda territorit te Bashkise se Tiranës. Ne keto objekte arsimore, sipas tabelës se mesiperme, shërbimi do te realizohet sipas planit ditor te ekzekutimit te shërbimeve te miratuar nga autoritetit kontraktor.

Afati i kryerjes së shërbimit: deri ne 30 (tridhjetë) ditë nga fillimi i kryerjes së shërbimit.

Metodologjite qe dote perdoret per kryerjen e shërbimeve duhet te jene te shoqeruara me garancite perkatese (te percaktuara ne DST dhe ne kontrate) ne marreveshjen e percaktimit te kushteve te garancise, para lidhjes se kontrates dote definohen dhe menytrat, koha, dhe 9do specifikim tjetër i vlefshëm dhe i detyrueshëm per palet kontraktuese. Perzgjedhja e specifikimeve teknike te nevojshëm per realizimin e kontrates eshte bere duke u bazuar tek standartet per pajisjet qe dote testohen gjate kryerjes se shërbimeve, ku jane te percaktuar vetem specifikimet baze te nevojshme me diapazon te arsyeshëm pasi ne praktike kjo ndryshon nga shume faktore te cilat ndikojne ne normat e percaktuara siç jane; lloji i materialeve, viti i prodhimit, natyra e lendes djegese, fuqia kalorifike, menyra e aplikimit te pajisjeve dhe destinacioni per te cilen dote perdoren.

Specifikimet teknike gjenden në shtojcën 6 të Dokumentave Standarte të Tenderit.

Shenim: Percaktoni specifikimet teknike, per shërbimet objekt prokurimi, qe dote perfshihen ne termat e references, ne perputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, te LPP, si dhe nenit 41, pika 1, te VKM nr. 285, date 19.05.2021, "*Per miratimin e rregullave te prokurimit publik* ", **duke argumeentuar çdo kerkese funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo reference duhet të *shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij / saj"*.

Kujdes: Ne specifikimet teknike, nese nuke justifikon objekti i kontrates, nuk duhet te permendet asnje marke prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, qe karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga nje operator ekonomik specifik apo asnje marke tregtare, patente, tipi ose origjine apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipermarrjeve ose produkteve. Nje gje e tille lejohet vetem ne raste perjashtimore kur nuk ekziston nje menyre e mjaftueshme, e sakte apo e kuptueshme e pershkrimtit te objektit te kontrates, sipas pikes 3 te nenit 36, te LPP. Referime te tilla duhet te shoqerohen nga fjalët "*ose ekuivalente*".

NJËSIA E PROKURIMIT